



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr.869/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Ahmet Rexhaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale kundër të akuzuarve: E.G, G. G dhe E. S për shkak se në bashkëveprim kanë kryer vepër penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2, lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II Nr.1884/2015 të datës 18.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të prokurores së shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuarve E G, G G dhe E S, e në mungesë të palës së dëmtuar F. S, me datë 30.10.2017 mori dhe shpalli si dhe me datë 20.11.2017 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari E. G i biri i N dhe i nënës A e gjinisë N i lindur me datë, në P, ku edhe tani jeton rruga “M M”, nr..., ka të kryer shkollën, me profesion, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

2. I akuzuari G. G, i biri i N dhe i nënës A e gjinisë N, i lindur me datë në fshatin K, tani me vendbanim në P, rruga “M.M”, nr... ka të kryer, i gjendjes, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

3. I akuzuari E. S i biri i B dhe i nënës K e gjinisë D, i lindur me datë në P, tani me banim në fshatin B, Komuna P, ka të kryer shkollën, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i gjendjes, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 20.09.2015, në Pejë, rreth orës 22:00, në rrugën “Ymer Basha” me mjetë të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, i shkaktojnë lëndime trupore të dëmtuarit F. S, në atë mënyrë që pas një marrëveshje paraprake në mes të të pandehurve E. G, G.G dhe E S, që ta sulmojnë personin e quajtur D. T të njëjtit shkojnë me veturën “R K” pronë e të pandehurit E S, në vendin e sipërshënuar, ashtu që dalin nga vetura, fshihen pas një muri duke e pritur dhe duke menduar se do ta takonin D T, me çrast me të arritur i dëmtuari F, fillimisht i pandehuri E gabimisht e godet me një shufër metalike në kokë duke menduar se është D, ndërsa më pas i bashkëngjiten edhe të pandehurit G dhe E S të cilët po ashtu e godasin të dëmtuarin me shufër në pjesë të ndryshme të trupit, ku si pasojë e kësaj i dëmtuari pëson lëndim të lehta trupor me plagë prerëse në regjionin e kokës.

-Me çka në bashkëveprim kanë kryer vepër penale, lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi.2 lidhur me paragrafin 1, nën. paragrafin 1.1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 41, 43, 45 par.1 dhe 2, neni 46,47,73 të KPRK-së, nenit 188 paragrafi.2 lidhur me paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarve : E.G., G. G.dhe E. S.:

G J Y K O N

Ashtu që të akuzuarin E. G i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve.

I njëjti dënim me pëlqimin e të akuzuarit E G i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, në kohëzgjatje prej 15 ditësh, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari E G që në emër të shpenzimeve të procedurës penale t’ia paguaj gjykatës shumë prej 20€, dhe të paushallit gjyqësor shumë prej 10€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit G G i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve.

I njëjti dënim me pëlqimin e të akuzuarit G.G i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, në kohëzgjatje prej 15 ditësh, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari G G që në emër të shpenzimeve të procedurës penale t'ia paguaj gjykatës shumën prej 20€, dhe të paushallit gjyqësor shumën prej 10€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit E S i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve

I njëjti dënim me pëlqimin e të akuzuarit E S i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqind euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë gjykata do ta zëvendësoi me dënim burgu, në kohëzgjatje prej 15 ditësh, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës.

Obligohet i akuzuari E S që në emër të shpenzimeve të procedurës penale t'ia paguaj gjykatës shumën prej 20€, dhe të paushallit gjyqësor shumën prej 10€, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar F S me vendbanim në P, rruga "I T", për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, departamenti për krime të përgjithshme, ka ngrit aktakuzë PP/II Nr. 1884/2015 të datës 18.12.2016, kundër të akuzuarve: E.G,G.Gme banim në P, dhe E.S nga f.sh B, Komua P, për shkak se në bashkëveprim kanë kryer vepër penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi.2 lidhur me paragrafin 1, nën. paragrafin 1.1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/II Nr. 1884/2015 të datës 18.12.2016, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarve iu ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarit për rendësin dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe i akuzuari E.G ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha pasojat e pranimin të fajësisë dhe e

pranon fajin për veprën penal me të cilën ngarkohet, gjithashtu ka deklaruar së është penduar dhe i ka kërkuar falje të dëmtuarit, dhe i ka kërkuar që të pajohet më të mirë po i njëjti ju ka deklaruar se ja ka lënë gjykatës të merr vendim.

I akuzuari G.G ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha pasojat e pranimit të fajësisë dhe se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.

I akuzuari E.S ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha pasojat e pranimit të fajësisë dhe se e pranon fajin për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, meqenëse të njëjtit e kanë pranuar fajin duke i kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa ndonjë presion dhe konsideron se i njëjti pranim i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarve, pasi që ata e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Akt ekspertimi mjeko-ligjor me nr. të Ref PE-210 i dt.05.12.2015, deklarata e të dëmtuarit F.S e dhënë në prokurori me dt.19.12.2015, deklarata e dëshmitarit G.K e dhënë me dt. 20.09.2015 në stacionin policor në Pejë, deklarata e dëshmitarit E.H e dhënë me dt.20.09.2015, në stacionin policor në Pejë, deklarata e dëshmitarit F.M dhënë me dt. 22.09.2015 në stacionin policor në P, deklaratat e të pandehurit E. G të dhëna me dt.23.09.2015 në Stacionin Policor në Pejë dhe me dt. 14.12.2015 në Prokurorinë Themelore në Pejë, deklaratat e të pandehurit E. S të dhëna me dt.23.09.2015 në Stacionin Policor në Pejë, deklaratat e të pandehurit G. G të dhëna me dt.27.09.2015 në stacionin Policor në Pejë, dhe me dt.14.12.2015 në Prokurorinë Themelore në Pejë, si dhe foto-dokumentacioni i shkresave të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e kanë pranuar fajësinë qysh në fillim, patën sjellje korrekte në shqyrtim fillestar, për gjykatën nuk ka të dhëna se të njëjtit kanë ra ndesh me ligjin më parë, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarit e lartcekur gjykata nuk ka gjete asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KRPK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, i obligoi të akuzuarit e lartcekur që secili veç e veç ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit i obligoi të akuzuarit që secili veç e veç ti paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Konform nenit 463 të KPPK-së, gjykata e udhëzoi palën e dëmtuar Fisnik Slihaj nga Peja, për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm,
P.nr.869/15, me datë 20.11.2017.**

Bashkëpunëtore profesionale
Besa Dervishaj

G J Y Q T A R I
Ahmet Rexhaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.